



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Municipality of Istog

01 Numër: 45/018

Data: 05.03.2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 43821

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 5 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), lidh:

MARRËVESHJE
ME KOMUNITETIN E LAGJES NURÇAJ NË FSH. KSHICË PËR NDËRTIMIN
E SHTËPISË SË KULTURËS ME PARTICIPIM

I. PALËT

E lidhur në Istog, më: 05.03.2018, në mes të:

1. Komunës së Istogut, të cilën e përfaqëson, z.Haki Rugova, Kryetari i Komunës, në njërën anë.
2. Kompania "Intering Construction" SH.P.K, të cilën e përfaqëson Lash Shoshi dhe
3. Komuniteti i lagjes Nurçaj në fshatit Kashicë, të cilët i përfaqësojnë: 1.Isuf Nurçaj, 2.Rrahman Nurçaj, 3.Arbnor Nurçaj, nga ana tjetër.

II. OBJEKT I MARRËVESHJES

Pika 1

Objekti i kësaj marrëveshje është participimi me mjete financiare i komunës dhe komunitetit të lagjes Nurçaj për ndërtimin e shtëpisë së kulturës në fshatin Kashicë.

Duke pasur parasysh kërkesat e kësaj lagjeje dhe participimin me mjete financiare për ndërtimin e shtëpisë së kulturës të lartpërmendur, të cilët bashkërisht kanë grumbulluar mjete financiare në shumë prej 23,810.00€ (njëzet e tre mijë e tetëqind e dhjetë euro), komuniteti ka bërë Marrëveshje me Kompaninë "Intering Construction" SH.P.K, për ndërtimin e shtëpisë së kulturës dhe kjo shumë nuk është e mjaftueshme dhe që kostoja për ndërtimin e kësaj shtëpie është më e lartë se sa mjetet të cilat i kanë grumbulluar banoret e kësaj lagjeje, atëherë:

Komuna për realizimin e këtij projekti ka ndarë shumën e mjeteve financiare në vlerë prej 6,400.00€ (gjashtë mijë e katërqind euro) nga kodi i projektit Nr.46385-Projekti në participim në komunitetin, të programit buxhetor të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.17517 fondi burimor Nr. 21.

Paramasa dhe parallogaria e projektit është në shumë prej 30,210.00€ (tridhjetë mijë e dyqind e dhjetë euro).

III. OBLIGIMET E KOMUNËS

Pika 2

Komuna përmes kësaj marrëveshje obligohet:

Që nga buxheti komunal, përkatësisht nga projekti Nr.43714-Projekti në participim në komunitet, të programit buxhetor të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.17517 fondi burimor Nr. 22, komuna ndanë mjetet financiare në shumë prej 5,000.00€ (pesë mijë euro) për ndërtimin e shtëpisë së kulturës sipas paramasës dhe parallogaritë;

- Qe mjetet financiare të lartcekura pas përfundimit të projektit t'i transferoj në xhirollogarinë e kryerësit të punimeve, përkatësish Kompanisë "Intering Construction" SH.P.K ;
- Të caktojë mbikëqyrësin për përcjelljen e realizimit të punimeve;
- Pas njoftimit mbi përfundimin e punimeve të caktoj komisionin për pranimin e punëve dhe një anëtar i komisionit të jetë nga komuniteti;
- Pas pranimin të faturës për punët e kryera t'ia transferoj mjetet financiare në xhirollogarinë e kryerësit të punimeve në pajtim me procedurat ligjore dhe
- Të ofrojë ndihmë përkatëse në realizim të projektit të lartcekur.

IV. OBLIGIMET E KOMUNITETIT

Pika 3

Komuniteti përmes kësaj marrëveshje obligohet:

- Të grumbulloj shumën shumë prej 23,810.00€(njëzet e tre mijë e tetëqind e dhjetë euro) dhe të njëjtat ti transferoj në xhirollogarinë e kryerësit të punimeve, përkatësish Kompanisë "Intering Construction" SH.P.K ;
- Të caktoj përfaqësuesin e komunitetit i cili do të bashkëpunoj me kryerësin e punëve dhe mbikëqyrësin në realizimin e këtij projekti;
- Të eliminojë pengesat e çfarëdo natyre qofshin ato, të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të projektit në fjalë;
- Pas përfundimit të punimeve të caktojnë një anëtar në komisionin për pranimin e punimeve;

V. OBLIGIMET E KOMPANISË "INTERING CONSTRUCTION" SH.P.K

Kompania përmes kësaj marrëveshje obligohet:

- Që ti kryej punët sipas projektit detal ekzekutiv të lartcekur;
- Ti zbatoj sugjerimet e organit mbikëqyrës për eliminimin e të metave eventuale; dhe
- Të dorëzoj faturën se bashku me dokumentacionin e duhur në komunë për realizimin e pjesës së cekur në pikën 1 të kësaj marrëveshje.

VI. OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

Pika 4

Palët e kësaj marrëveshje do të angazhohen që të gjitha obligimet e përcaktuara në këtë marrëveshje t'i zbatojnë më përpikëri.

Palët në marrëveshje për çdo paqartësi apo vërejte, në zbatim të obligimeve të kësaj marrëveshje komunikojnë në mes veti në formë të shkruar.

VII. NDRYSHIMI I MARRËVESHJES

Pika 5

Kjo marrëveshje apo një pjesë e kësaj marrëveshje mund të ndryshohet apo modifikohet nëse palët për këtë ndryshim apo modifikim pajtohen. Ndryshimi bëhet në formë të shkruar dhe është aneks i kësaj marrëveshje.

VIII. DISPOZITAT E FUNDIT

Pika 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi më nënshkrimin e saj nga palët në marrëveshje.

Pika 7

Në rast të çdo mosmarrëveshje palët do të përpiqen që të njëjtat t'i zgjedhin përmes bisedimeve të ndërsjella. Në rast të dështimit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve eventuale përmes bisedimeve, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata Themelore Pejë - Dega në Istog.


Marrëveshja është hartuar në 4 kopje identike njëra me tjetrën, një kopje për Komunitetin e fshatit Prigodë, një kopje për Drejtorin për Buxhet dhe Financa dhe dy kopje mbasin në arkivin e komunës.

PALËT NË MARRËVESHJE

PËR KOMUNËN E ISTOGUT

Kryetari i Komunës

z. Haki RUGOVA



nënshkruar me: 06/03/2018

PËR KOMPANINË "Intering Construction" SH.P.K

Drejtori i Kompanisë

z. Lash Shoshi



nënshkruar me: 06/03/2018

PËR KOMUNITETIN E FSH. KASHICË

Përfaqësuesit e komunitetit

1.z. Isuf Nurçaj,

2.z. Rrahman Nurçaj,

3.z. Arbnor Nurçaj,



nënshkruar me: 06/03/2018

